



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 1113/25

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Isa Hasani - Kryetar, Kimete Gashi si dhe Vedat Poterqoi - Anëtarë, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Komuna Gjakovë, me numër 1113/25, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE "Finesë Design" Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Skena, ndriçimi dhe zërimi për organizime të ndryshme", me numër të prokurimit: 632-25-6063-2-2-1, iniciuar nga Komuna Gjakovë, më 09.10.2025 mori këtë:

V E N D I M

1. APROVOHET, si e bazuar kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Komuna Gjakovë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "Finesë Design" Sh.p.k, me nr: unik: 811973925 - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Skena, ndriçimi dhe zërimi për organizime të ndryshme, me nr: të prokurimit: 632-25-6063-2-2-1, iniciuar nga Komuna Gjakovës.

2. Diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit OE "Finesë Design" Sh.p.k, sipas nenit 99.2 të LPP-së dhe nenit 67.9, të Rregullores PP nr.002/2024, lidhur shkeljen e ligjit në aktivitetin e prokurimit sipas pikës një (1) të vendimit dhe diskualifikohet për periudhën kohore në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, duke filluar nga data, 09.10.2025 e deri më 08.01.2026.

ARSYETIM

Kërkesa e AK - Komuna Gjakovë:

1. Autoriteti kontraktues pretendon se OE Finesë Design Sh.p.k, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Skena, ndriçimi dhe zërimi për organizime të ndryshme, me nr: te prokurimit: 632-25-6063-2-2-1, ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 të Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, duke arsyetuar se operatorit ekonomik Finesë Design Sh.p.k, i jemi drejtuar me kërkesë për dokumentet e provueshmërisë sipas nenit 65 të LPP-se.
2. OE Finesë Design Sh.p.k, nuk i është përgjigjur kërkesës së autoritetit kontraktues sipas kërkesës dhe brenda afatit të përcaktuar, pra sipas AK-se, veprimet e OE Finesë Design Sh.p.k, bien në kundërshtim me nenin 25 të Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022.

Mbi bazën e sqarimeve të dhëna me lartë, autoriteti kontraktues kërkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 të LPP-se me pretendimin se OE Finesë Design Sh.p.k.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të pranuar kërkesën e datës: 07.08.2025, të AK - Komuna Gjakovë, e ka njoftuar OE Finesë Design Sh.p.k, me qëllim që operatori ekonomik në fjalë të jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se dhe në përgjigje të kërkesës së OSHP-se, OE Finesë Design Sh.p.k, ka kërkuar që kërkesa e AK-se, të refuzohet si e pa bazuar.

Me tutje në sqarimin e tij OE Finesë Design Sh.p.k ka deklaruar se arsyetimi i dhënë për këtë vendim lidhet me mos ngarkimin në sistem të disa dokumenteve të kërkuara brenda afatit ligjor, meqë punonjësja përgjegjëse e administratës, e cila menaxhonte procedurat e prokurimit, nuk ka kontrolluar në kohë platformën e e-prokurimit. Si pasojë e këtij gabimi teknik dhe jo të qëllimshëm, kompania jonë humbi mundësinë për të dorëzuar dokumentet në kohë dhe, rrjedhimisht, për të fituar këtë tender.

Theksojmë se kjo situatë nuk ka ardhur si rezultat i paraqitjes së të dhënave të rreme apo dokumenteve të falsifikuara nga ana jonë, por si pasojë e një neglizhence administrative të brendshme, e cila nuk ka pasur për qëllim shkeljen e dispozitave ligjore. Gjithashtu, ju informojmë se punonjësja e cila ka qenë përgjegjëse për këtë proces tashmë nuk është pjesë e kompanisë.

Vlerësimi i pretendimeve të autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj OE "Finesë Design" Sh.p.k:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave paneli shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues – Komuna Gjakovë, ka dorëzuar prova që dëshmojnë se OE Finesë Design Sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me nenin 25.9 të Rregullores për prokurim, në të cilin thuhet:

25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.

Paneli shqyrtues sqaron se për marrjen e masave ndaj operatorëve ekonomik Organi Shqyrtues i Prokurimit mund të veprojë vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkeje me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, ka dorëzuar prova se OE Finesë Design Sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me nenin 25.9 të Rregullores Prokurimit Publik, nr.002/2024 dhe njeherit i njëjti e ka detyruar AK – Komuna Gjakovë të vazhdojë me ofertën e dytë me radhë.

Andaj, paneli shqyrtues vlerëson se OE Finesë Design Sh.p.k, duhet, **të diskualifikohet në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, nga pjesëmarrja në prokurim publik, për të gjitha procedurat e prokurimit, ashtu si është e përcaktuar me nenin 67.9, Rregullorja për Prokurim Publik Nr. 002/2024, si në vijim;**

” Në rast se OSHP nxjerr një vendim për diskualifikim të një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në prokurimin publik prej datës së vendimit. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, “Pjesëmarrja në prokurim publik” është një proces që përfshin tërë ciklin nga njoftimi, aplikimi, përfshirë edhe çfarëdo kundërshtimi apo ankese, deri të vendimi për dhënie të kontratës, rrjedhimisht pamundëson çfarëdo veprimi që Operatori Ekonomik mund të ndërmerr përgjatë tërë procesit

të prokurimit prej fazës së publikimit të njoftimit për kontratë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, përfshirë edhe parashtrimin e ankesave. Ky përjashtim vlen për të gjitha llojet e kontratave dhe për të gjitha procedurat e prokurimit”.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Gjakovë

1x1 OE Finesë Design Sh.p.k

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

